



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**VENDIM**

**NR. 1, DATË 16.01.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E LICENCËS SË TRANSMETIMIT  
AUDIO PËR QËLLIME TË PËRKOHSHME DHE NEVOJA INSTITUCIONALE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1/ë dhe 16 dhe nenit 66 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rregullores “Për dhënie e licencës të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**RREGULLORE PËR  
DHËNIEN E LICENCAVE TË TRANSMETIMIT AUDIO PËR QËLLIME TË  
PËRKOHSHME DHE NEVOJA INSTITUCIONALE**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale.

**Neni 2  
Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 3  
Fusha e zbatimit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për dhënien e:

1. Licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme institucioneve publike për:
  - 1.1. Sigurimin e nevojave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore (emergjencat civile), rendin publik dhe sigurinë kombëtare.
  - 1.2. Sigurimin e nevojave të tjera të përkohshme.
2. Licencave të transmetimit audio për plotësimin e nevojave institucionale, subjekteve të mëposhtme:
  - 2.1. Institucioneve arsimore.
  - 2.2. Institucioneve shëndetësore.

#### **Neni 4**

### **Shqyrtimi i kërkesave**

1. Shqyrtimi i kërkesave për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale, kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD).
2. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit ngrihet me urdhër të Kryetarit dhe përbëhet Zëvendëskryetari, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit dhe nga Drejtorët e Drejtorive të AMA-s ose nga 1(një) përfaqësues i çdo drejtorie të administratës.
3. Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit shqyrtojnë të dhënat e paraqitura nga subjektet. Në rast se, KSHD konstaton mangësi në dokumentacionin e aplikimit, i propozon Kryetarit të AMA-s, lënien e një afati 10 ditor subjektit aplikues për të kryer plotësimet e nevojshme.
4. Në kuadër të vlerësimit, KSHD përgatit relacionin përmbledhës, i cili është i shoqëruar me propozimin përkatës dhe ia përcjell AMA-s për vendimmarrje.

#### **Neni 5**

### **Cilësia e mbulimit**

1. Mbulimi me sinjal radio FM tokësore duhet të jetë sipas Rekomandimit ITU-R, BS 412-9 të ITU.
2. Pajisjet e prodhimit e transmetimit të programeve audio FM duhet të sigurojnë zbatimin e standardeve e normave teknike në prodhim dhe transmetim të miratuara nga ETSI dhe organizatat e tjera të specializuara ndërkombëtare.
3. Pajisjet që do të përdoren duhet të projektohen, ndërtohen, mirëmbahen dhe shfrytëzohen në mënyrë që përdorimi i tyre të mos shkaktojë asnjë interferencë të dëmshme tek asnjë përdorues tjetër i spektrit të radiofrekuencave.

#### **Neni 6**

### **Standardet programore**

Subjektet e licencuar për transmetime audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale janë të detyruar të respektojnë standardet programeve, duke patur parasysh:

- a. Nxitjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit.
- b. Respektimin e paanshmërisë, plotësisë e pluralizmit të informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinionëve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
- c. Respektimin e mirëkuptimit dhe tolerancës të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
- d. Promovimin e kulturës kombëtare shqiptare dhe gjuhës shqiptare;
- e. Respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut;
- f. Respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- g. Respektimin e privatësisë së individit;
- h. Respektimin e diversitetit fetar dhe racës;

- i. Respektimin e ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
- j. Respektimin e normave morale dhe etike të shoqërisë;
- k. Respektimin e të drejtën e përgjigjes,

si dhe kërkesa të tjera, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **KREU II**

### **LICENCAT E TRANSMETIMIT AUDIO PËR QËLLIME TË PËRKOHSHME**

#### **Neni 7**

##### **Zona e mbulimit**

Licenca e transmetimit audio për qëllime të përkohshme jepet për të mbuluar me sinjal audio hapësirën deri në një qark për shërbim transmetimi audio lokal dhe deri në katër qarqe me vijimësi gjeografike për një shërbim transmetimi audio rajonal.

#### **Neni 9**

##### **Licencimi**

Të drejtën për t’u pajisur me licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme e kanë institucionet publike të mëposhtme:

1. Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile (qendrore, vendore, operationale) në rastet e fatkeqësive natyrore dhe njerëzore (emergjencës civile), strukturave publike përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.
2. Organet e pushtetit qendror dhe vendor në rastin e aktiviteteve të organizuara prej tyre.

#### **Neni 10**

##### **Kërkesa**

Subjektet sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje paraqesin kërkesë pranë AMA-s për licencë të përkohshme transmetimi audio:

1. Për sigurimin e nevojave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore (emergjencat civile), rendin publik dhe sigurinë kombëtare, kërkesa, paraqitet menjëherë dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
  - b. Subjektin kërkues;
  - c. Zonën e mbulimit për të cilën shfaqet interes;
  - d. Afatin e propozuar të licencës;
  - e. Informacion mbi nevojën për mbulimin me shërbim audio të zonës;
  - f. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekt-idenë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit audio ku përfshihen studioja e transmetimit dhe pajisjet transmetuese.

2. Në rastin e aktiviteteve të tjera, kërkesa, paraqitet jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
  - a. Subjektin kërkues;
  - b. Zonën e mbulimit për të cilën shfaqet interes;
  - c. Afatin e propozuar të licencës;
  - d. Emërtimin e programit;
  - e. Informacion mbi aktivitetin që do të zhvillohet dhe përfitimet e pritshme sociale, ekonomike, kulturore në zonën e licencimit.
  - f. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekt-idenë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit audio ku përfshihen studioja e transmetimit dhe pajisjet transmetuese.
3. Kërkesat e nenit 33 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar për transmetimin e çështjeve të aktualitetit lokal, kërkesat për dhënien e licencës së transmetimit audio për rrjete analoge dhe kufizimet e pronësisë nuk zbatohen për licencën e transmetimit audio për qëllime të përkohshme.

## Neni 11

### Vendimi për dhënien e licencave për qëllime të përkohshme

1. Për sigurimin e nevojave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore (emergjencat civile), rendin publik dhe sigurinë kombëtare:
  - 1.1 AMA, në përputhje me planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, vendos për dhënien e licencës së transmetimit audio për qëllime të përkohshme jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.
  - 1.2 AMA, në rast të mungesës së frekuencave të lira, kërkon nga OSHMA-të që ushtrojnë veprimtari audio dhe audiovizive, që gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes për publikun e zonës që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik e sigurinë kombëtare. Organet e pushtetit vendor kanë të drejtë të kërkojnë hapësira kohore më të mëdha për trajtimin e çështjeve të emergjencës civile, mbi bazën e marrëveshjes me OSHMA-në/të e zonës, duke respektuar në çdo rast pavarësi në editoriale të tij/tyre.
2. Në rastin e organizimit të aktiviteteve:
  - 2.1. AMA, në përputhje me planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, vendos për dhënien e licencës së transmetimit audio për qëllime të përkohshme në rastin e zhvillimit të aktiviteteve të veçanta sportive, kulturore – artistike, argëtuese etj (kombëtare/ndërkombëtare).
  - 2.2. AMA, në rast të mungesës së frekuencave lira, refuzon kërkesën për licencë.
  - 2.3. Në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme dhe disponibiliteti i frekuencave nuk lejon dhënien e dy ose më shumë licencave të tilla, AMA vendos dhënien e licencës së transmetimit audio për qëllime të përkohshme, duke u bazuar në parimin “*cili vjen i pari, shërbehet i pari*”.

## Neni 12

## **Kufizime**

1. Licenca e transmetimit audio për qëllime të përkohshme nuk jepet 6 muaj para datës së zhvillimit të zgjedhjeve vendore apo zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, me përjashtim të rasteve që lidhen me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.
2. Kufizimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe në rastin e zhvillimit të zgjedhjeve të parakohshme vendore apo parlamentare.

## **Neni 13**

### **Afati i licencës së transmetimit audio për qëllime të përkohshme**

Licenca e transmetimit audio për qëllime të përkohshme, pavarësisht subjektit të licencuar jepet me afat:

- a. deri në 60 ditë në vijimësi, brenda një viti kalendarik, kur zona e mbulimit është deri në 4 qarqe;
- b. deri në 120 ditë në vijimësi brenda një viti kalendarik, kur zona e mbulimit është deri në 1 qark.

## **Neni 14**

### **Detyrimet financiare**

1. Licencat e transmetimit audio për qëllime të përkohshme lëshuar institucioneve për sigurimin e nevojave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore (emergjencat civile), rendin publik dhe sigurinë kombëtare, përjashtohen nga pagesat.
2. Pagesat për licencat e transmetimit audio për qëllime të përkohshme lëshuar për organet e pushtetit qendror dhe vendor në rastin e aktiviteteve të organizuara prej tyre përcaktohen në vendimin/vendimet e pagesave në fuqi.

## **KREU II**

### **LICENCA E TRANSMETIMIT AUDIO PËR NEVOJA INSTITUCIONALE**

## **Neni 15**

### **Zona e mbulimit**

Licenca e transmetimit audio për nevoja institucionale jepet për të mbuluar me sinjal audio një zonë të caktuar duke përdorur stacione transmetues me fuqi të ulët.

## **Neni 16**

### **Kërkesa të përgjithshme të aplikimit për licencë transmetimi audio**

1. Të drejtën për t'u pajisur me licencë transmetimi audio për nevoja institucionale e kanë subjektet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
2. Kërkesa për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale, paraqitet pranë AMA-s dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a. Subjektin kërkues, emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të tij.
  - b. Emërtimin e programit;
  - c. Kohëzgjatjen e transmetimit të programit gjatë 24 orëve;
  - d. Planifikimin financiar mbi shpenzimet për shërbimin e kërkuar;
  - e. Zonën e mbulimit për të cilën shfaqet interes;
  - f. Informacion mbi objektin e veprimtarisë dhe nevojën për ofrimin e shërbimit;
  - g. Përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë informacionit;
  - h. Mënyra e organizimit të shërbimit (stafi editorial për këtë shërbim, stafi teknik etj);
  - i. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekt-idenë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit audio ku përfshihen studioja e transmetimit dhe pajisjet transmetuese.
3. Kërkesat e nenit 33 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar për transmetimin e çështjeve të aktualitetit lokal, kërkesat për dhënien e licencës së transmetimit audio për rrjete analoge dhe kufizimet e pronësisë nuk zbatohen për licencën e transmetimit audio për nevoja institucionale.

#### **Neni 17** **Shqyrtimi i kërkesave**

1. Kërkesat për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale shqyrtohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre.
2. Në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale dhe disponibiliteti i frekuencave nuk lejon dhënien e dy ose më shumë licencave, AMA vendos duke u bazuar në parimin “*cili vjen i pari, shërbehet i pari*”.

#### **Neni 18** **Vendimi për dhënien e licencës të transmetimit audio për nevoja institucionale**

AMA vendos për dhënien ose jo të licencës së transmetimit audio për nevoja institucionale brenda 50 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

#### **Neni 19** **Afati i licencës së transmetimit audio për nevoja institucionale**

Licenca e transmetimit audio për nevoja institucionale jepet me afat deri në 3 vjet me të drejtë rinovimi.

#### **Neni 20** **Detyrimet financiare**

Pagesat për licencat e transmetimit audio për nevoja institucionale përcaktohen në vendimin/vendimet e pagesave në fuqi.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.